

---

---

## MATERIALE SHKENCORE E KUMTESA

---

---

HALIM PURELLKU

halimpurellku@hotmail.com

### SHTRIRJA E KRYENGRITJES SHQIPTARE E VITIT 1912 NË KRAHINËN E DIBRËS\*

Përgatitjet për fillimin e kryengritjes shqiptare kundërosmane, kishin filluar që në dimrin e vitit 1911-1912.<sup>1</sup> Në këtë kuadër, më 20 janar të vitit 1912, në Dibër, qe organizuar një miting në të cilin u shtrua kërkesa që po ato të drejta që u njiheshin malësorëve, me marrëveshjen e Podgoricës (2 gusht 1911), t'i njiheshin edhe popullatës së krahinës së Dibrës. Vendimet e këtij kuvendi iu dërguan edhe deputetëve shqiptarë, në Stamboll, për informim.<sup>2</sup> Kryengritja në Shqipërinë e Veriut shpërtheu nga mesi i muajit prill të vitit 1912 dhe u shtri, apo së paku ndihej, në të gjithë Shqipërinë (Arnautllëkun),<sup>3</sup> apo siç pohonte shtypi i kohës në Beograd, kryengritja shtrihej nga kufiri shtetëror me Serbinë, në veri, e “deri në kufijtë më të skajshëm jugor” të Shqipërisë, në jug, dhe nga brigjet e Liqenit të Shkodrës, në perëndim, e deri në Vardar, në lindje.<sup>4</sup>

---

\* Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore me temë: “100 vjet nga Lufta e Dibrës”, organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve të Historisë Ushtarake dhe shoqatën “Çidhna dhe Kastriotët”, Tiranë, më 20 dhjetor 2021.

<sup>1</sup> *Haus Hof und Staats archiv, Politisches Archhiv, Wien* (më tej: *HHSTA.PA.A.*) në *Arkivi i Institutit të Historisë*, Tiranë (më tej: *AIH*), Vj. 22-2-288. Telegram nr. 102 i Kral-it drejtuar Berchtold-it, Selanik, më 25 qershor 1912.

<sup>2</sup> *Po aty*, Vj. 22-11-1102. Telegram nr. 5, i Halla-s, drejtuar baronit Erental, Manastir, 5 shkurt 1912; Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare (1911-1912)*, Libri 2, Instituti i Historisë-Prishtinë (Prishtinë: KGT, 2004), 160.

<sup>3</sup> *HHSTA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-2-288. Telegram nr. 102 i Kral-it drejtuar Berchtold-it, Selanik, më 25 qershor 1912.

<sup>4</sup> “Побуна Арнаута (Данашњи хаос у Турској)” (“Pobina Arnauta (Danashni haos u Turskoj)”), gazeta *Борба (Borba)*, Бр. 26, Београд (Beograd), 3/18.05.1912; “Ширење Арбанског покрета” (Shirenje Arbanskog Pokreta), *Борба (Borba)*, Бр. 36, Београд (Beograd), 15/28.05.1912; “Арнаути у Софији” (Arnauti i Sofiji), gazeta *Политика (Politika)*, Бр. 2985, Београд (Beograd), 10/23.05.1912; “Арнаутска

Ndërkaq, Hasan Ballanca, nga Dibra, një veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare, në deklaratën e tij për gazetën bullgare “Reç”, vlerëson se lëvizja aktuale revolucionare / kryengritëse në Shqipëri, nuk ishte si ato të mëparshmet në kuptimin e shkallës së organizimit dhe të karakterit të saj.<sup>5</sup>

Ndërkaq, që në fillim të marsit të vitit 1912, qeveria osmane mori masa për parandalimin e kryengritjes. Për këtë qëllim, ajo ngarkoi Feti Pashën, komandant i Korpusit VI, dhe valiun e Manastirit, të bisedonin me disa figura të jetës publike e politike shqiptare, si: Dervish Hima, Fehim Bej Zavalani, Abdyl Bej Ypi, Baba Hysenin e Melçanit, për t’iu kërkuar atyre që shqiptarët të qëndronin asnjans (neutralë) në luftën politike midis pozitës dhe opozitës osmane, si dhe të hiqnin dorë nga ideja e kryengritjes.<sup>6</sup> Megjithatë, kryengritja u shtri edhe në vilajetin e Manastirit, përkatësisht edhe në sanxhakun e Dibrës.<sup>7</sup> Organizimi i çetave kryengritëse dhe rebelimi i tyre në krahinën e Dibrës u duk nga fundi i prillit të vitit 1912, kur Basri Beu u arratis në mal dhe grumbulloi disa qindra kryengritës shqiptarë.<sup>8</sup> Krahas, Basri Beut, u rebeluan edhe disa krerë me ndikim ndër malësorët, si: Mersim Dema, Elez Isufi, Sejfedin Pustina, Shaqir Beu e Salih Bej Lacko. Takimet dhe konsultimet midis tyre i mbanin në Shupenzë (Dibër).<sup>9</sup> Nga prijësit më të shquar të kryengritjes në krahinën e Dibrës ishte Mersim Dema, i cili me çetën e tij (50 veta) zhvilloi një veprimtari shumë efikase, në favor të masivizimit të kryengritjes. Ndërkohë, nga fundi i prillit 1912, në Dibrën e Poshtme (Vogël) nga këta krerë qenë organizuar dhe vepronin disa çeta

революција” (Arnautska revolucija), gazeta *Политика* (Politika), Бр. 2986, Београд (Beograd), 11/24.05.1912; “Вихор у Турској” (Vihor u Turskoj), gazeta *Политика* (Politika), Бр. 3042, Београд (Beograd), 8/21.07.1912.

<sup>5</sup> “Арнаути у Софији” (Arnauti i Sofiji), gazeta *Политика* (Politika), Бр. 2985, Београд, 10/23.05.1912; “Арнаутска револуција” (Arnautska revolucija), gazeta *Политика* (Politika), Бр. 2986, Београд, 11/24.05.1912.

<sup>6</sup> *ННСТА.ПА.А. në АИИ, Vj. 22-19-1957. Telegram nr. 18 konfidencial, i konsullit Halla drejtuar kontit Berchtold, Manastir, 9 mars 1912.*

<sup>7</sup> “Писмо из Призрена (Од нашег редоног дописника-30.04./13.05.1912)” (Pismo iz Prizrena (Od nasheg redonog dopisnika), gazeta *Борба* (Borba), Бр. 30, Београд, 7/20.05.1912.

<sup>8</sup> “За Басри-бејом” (За Basri-bejom), gazeta *Политика* (Politika), Бр. 2980, Београд, 5/18.05.1912.

<sup>9</sup> *ННСТА.ПА.А. në АИИ, Vj. 22-17-1757. Telegram i Halla-s, Manastir, 27 maj 1912.*

kryengritëse me efektiva nga 40-50 veta secila nga ato.<sup>10</sup> Kryengritësit kishin këshilltarët dhe instruktorët e tyre në qytetin e Dibrës: Sefedin Pustinën, Shukri Beun etj.<sup>11</sup>

Krerët e Dibrës (gjithsej 39 veta), nga fundi i prillit të vitit 1912, me anë të një telegrami protestuan pranë qeverisë osmane, kundër praktikës së shkeljes flagrante të procesit zgjedhor nga ana e pushtetit, në sanxhakun e Dibrës.<sup>12</sup> Por, qeveria osmane në vend që të ndalonte praktikën e shkeljes flagrante të procesit zgjedhor, dërgoi në sanxhakun e Dibrës një ekspeditë të madhe në ndjekje të çetës së Basri Beut. Përleshjet midis ushtrisë dhe kryengritësve, në Malësinë e Dibrës, filluan nga fundi i prillit - fillimi i majit 1912. U zhvilluan tri përleshje në fshatrat: Reç, Dardhë dhe Çidhën. Gazeta “Politika” e Beogradit e vlerësonte kryengritjen e Dibrës si shumë serioze “më të organizuar se asnjëherë më parë”.<sup>13</sup> Në dhjetëditëshin e parë të majit, kryengritja në Dibër po merrte përmasa gjithnjë e më të mëdha. Thuajse e gjithë Malësia e Dibrës qe ngritur në kryengritje. Kjo rezultoi me luftime të shpeshta, herë pas here të formës frontale, ndërmjet fuqive kryengritëse dhe ushtrisë osmane gjatë muajit maj të vitit 1912, dhe atë ndërmjet fshatrave Dardhë dhe Reç, te fshati Topojan, te fshati Lis, te lumi Lusi etj. Kështu, më 4 maj 1912, forcat ushtarake u përleshën me çetën e Elez Isufit, ku mbetën të vrarë dy shqiptarë dhe 11 ushtarë osmanë të vrarë e të plagosur.<sup>14</sup> Ndërkaq, rreth datës 14 maj, trupat osmane të Batalionit të dytë të Regjimentit të 49-të në luftë me kryengritësit shqiptarë pësuan humbje të mëdha në njerëz; rreth 100 ushtarë të vrarë.<sup>15</sup> Kurse, rreth datës 17 maj, në fshatrat Reç e Dardhë të Malësisë së Dibrës pati një përprjekje tjetër të luftës frontale midis çetave shqiptare dhe trupave

<sup>10</sup> *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914 (Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914)*, Књига 5 (Knjiga), Свеска 1 (Sveska), 1/14. јануар-14/27. јули 1912 (1/14 јануар - 14/27 јули 1912), Приредио Михајло Војводић (Priredio Mihajlo Vojvoditch) (Београд: 1984), dok. nr. 401 (665).

<sup>11</sup> *Po aty*, dok. nr. 351 (602).

<sup>12</sup> *ННСТА.РА.А. нe АИН, Vj. 22-17-1754*. Shtojcë e raportit nga Manastiri, 1 maj 1912.

<sup>13</sup> *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914 (Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914)*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 316 (561); “Арнаутска буна” (Arnautska buna), gazeta *Политика* (Politika), Бр. 2975, Београд (Beograd), 30 априлла/13.05.1912.

<sup>14</sup> *Po aty*, dok. nr. 401 (665).

<sup>15</sup> “Побуна Арнауца” (Pobina Arnauta), gazeta *Борба* (Borba), Бр. 25, Београд, 2/15.05.1912.

osmane. Kryengritësve u erdhën në ndihmë Mersim Dema me 400 luftëtarë dhe fshatarët e fshatrave përreth. Përpara mësymjes së fuqive kryengritëse, trupat osmane ishin të detyruara të zmbropseshin.<sup>16</sup>

Shumë shpejt pas këtyre përlshjeve, nga Manastiri arriti në Dibër Feti Pasha, me një regjiment të këmbësorisë dhe me një bateri kodrinore, për të demonstruar forcën. Feti Pasha deklaroi se gjoja kishte ardhur për t'ua komunikuar prijësve të kryengritjes përgjigjen e qeverisë, lidhur me 10 kërkesat me shkrim të Dibrës së Poshtme dhe të Matit, dorëzuar Haxhi Adil Beut. Në këtë kuadër, ai i ftoi kryengritësit të shpërndahen nëpër shtëpitë e tyre dhe urdhëroi ushtrinë të ndërpriste ndjekjen e kryengritësve. Pastaj, Feti Pasha, më 23 maj 1912, shkoi në Homesh, qendër e kryengritjes në Malësinë e Dibrës. Aty ai ua përcolli prijësve të kryengritjes vendimin e qeverisë osmane, se shqiptarët e sanxhakut të Dibrës për disa vjet do të liroheshin nga shërbimi ushtarak dhe se do të hiqeshin taksat e reja. Ndërkaq, udhëheqësve të kryengritjes, Basri Beut dhe Mersim Demës, nëpërmjet Shaqir Beut, u bëri oferta shumë solide në ofiqe e të holla për të ndërprerë kryengritjen, por prijësit e kryengritjes i refuzuan këto oferta.<sup>17</sup> Gjithashtu, nga fundi i majit, në Dibër arriti edhe telegrami nga Stambolli, me anë të të cilit konfirmohej se ishte anuluar për tre vjet tatimi për shqiptarët kryengritës, dhe se ishte anuluar për tre vjet edhe shërbimi ushtarak, si dhe ishte legalizuar mbajtja e armëve.<sup>18</sup> Ndërkohë, më 26 maj 1912, valiu i Manastirit deklaroi, se janë shpërndarë kryengritësit përreth Dibrës, kundruall disa koncesioneve të pushtetit.<sup>19</sup>

Përpjekjet e qeverisë osmane për shuarjen e kryengritjes në sanxhakun e Dibrës me mjete paqësore, vazhduan edhe gjatë muajit

<sup>16</sup> “Сукоб војске са Арнаутима” (Sukob vojske sa Arnautima), gazeta *Борба (Vorba)*, Бр. 28, Београд, 5/18.05.1912.

<sup>17</sup> *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914 (Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914)*, Књг. 5, св. 1, док. нр. 401 (663-665); “Побуна Арнаута (Ради преговиора с Арнаутима) dhe (Побуна се још шири)” / (“Pobina Arnauta (Radi pregoviора s Arnautima dhe Pobina se josh shiri”), gazeta *Борба (Vorba)*, Бр. 37, Београд, 16/29.05.1912; “Борба с Арнаутима” (Vorba s Arnautima), gazeta *Политика (Politika)*, Бр. 2989, Београд, 16-29.05.1912; Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare*, 231, 235.

<sup>18</sup> *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914 (Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914)*, Књг. 5, св. 1, док. нр. 435 (703).

<sup>19</sup> “Борба с Арнаутима” (Vorba s Arnautima), gazeta *Политика (Politika)*, Бр. 2988, Београд, 15/28.05.1912.

qershor të vitit 1912. Menjëherë pas deklaratës së valiut të Manastirit, të 26 majit 1912, paraprakisht, u evakuua ushtria osmane nga Malësia e Dibrës, në javën e parë të qershorit, siç duket ky ishte kushti i shqiptarëve për të hyrë në bisedime me pushtetin. Ndërkaq, nga mesi i qershorit, në Dibër arriti një delegacion i përbërë nga Feti Pasha dhe Ejup Sabri Beu, sekretar i Komitetit Qendror xhonturk, për negociata me kryengritësit, ngaqë “e gjithë Malësia e Dibrës qe arratisur në mal”. Bisedimet midis pushtetit dhe përfaqësuesve shqiptarë për një marrëveshje të përkohshme u zhvilluan në Dibër. Këto negociata rezultuan me pranimin formal të kushteve të delegacionit osman dhe me zotimin e përfaqësuesve shqiptarë se kryengritësit do të shpërndahen nëpër shtëpitë e tyre.<sup>20</sup> Për rrjedhojë, nga fundi i qershorit në Dibër nuk kishte përleshje, por burimet bëjnë të ditur se ende nuk ishte arritur një marrëveshje midis kryengritësve dhe pushtetit.<sup>21</sup>

Megjithatë, në fund të majit 1912, qeveria osmane vazhdonte të përqendronte trupa ushtarake shtesë në Dibër dhe në Kërçovë.<sup>22</sup> Por, edhe prijësit shqiptarë të vilajetit të Manastirit vazhdonin të forconin lidhjet me Shqipërinë e Sipërme.<sup>23</sup> Kral, konsulli austro-hungarez në Selanik, njoftoi eprorët e tij se me përpjekjen e disa personaliteteve - figurave shqiptare, në qershor të vitit 1912, ishte bërë përparim në arritjen e marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet krahinave të Shqipërisë për kryengritje të përbashkët kundërosmane, por ende ishin larg nga një marrëveshje “më e sigurt dhe më aktive”, siç do të duhej të ishte.<sup>24</sup>

Por, element i rëndësishëm në zhvillimet politike në vilajetin e Manastirit gjatë qershorit të vitit 1912, ishte revolta antiqeveritare në ushtri (21-22 qershor 1912), kur një pjesë e ushtarakëve u bashkuan me kryengritësit, dhe së bashku me trupat e dezertuara u arratisën edhe shumë krerë të zonave përkatëse në këtë vilajet. Kështu, me trupat e dezertuara nga garnizoni i Dibrës, më 22 qershor 1912, u arratisën edhe

<sup>20</sup> *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914 (Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914)*, 19, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 480 (771); “Мир у Дебру, Арнаутска револуција” (Mir u Derbu, (Arnautska revolucija), gazeta *Политика (Politika)*, Бр. 3007, Београд, 3/16.06.1912.

<sup>21</sup> *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914 (Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914)*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 513 (814).

<sup>22</sup> *По ату*, dok. nr. 435 (701-703).

<sup>23</sup> *По ату* (702).

<sup>24</sup> *ННСТА.ПА.А. në AIH*, Vj. 22.2.288. Raport i konsullit austro-hungarez Kral drejtuar kontit Berchtold, Selanik, 25 qershor 1912.

12 krerë nga sanxhaku i Dibrës, të cilët qëndronin në Malësinë e Dibrës, me 80-100 burra.<sup>25</sup> Ndërkaq, në gjysmën e parë të korrikut, kryengritja shqiptare po merrte gjithnjë e më shumë hov si në Veri, ashtu edhe në Jug.<sup>26</sup> Në fillim të korrikut ishin të shpeshta përpjekjet luftarake ndërmjet ushtrisë dhe kryengritësve shqiptarë në Dibër të Vogël, në Rekë të Dibrës, në Mat, por pa ndonjë rëndësi të madhe.<sup>27</sup> Në Dibër vazhdonte të mbisundonte anarkia edhe nga mesi i korrikut. Kryengritësit i prenë linjat telegrafike dhe ndërprejnë çdo komunikim të Dibrës me Strugën, me Dibërën e Poshtme dhe me Zhernanicën. Njoftoj se, edhe rreth gjysma e ushtrisë nga postëkomandat ndihmëse iu bashkua kryengritësve.<sup>28</sup> Ndërkaq, në gjysmën e dytë të korrikut, u shtua ndjeshëm numri i kryengritësve në Malësinë e Dibrës, në Mat etj. Për shtypjen e kryengritjes në këto treva pushteti dërgoi trupa shtesë.<sup>29</sup>

Por, nga mesi i korrikut të vitit 1912, kur pothuajse në të gjitha “Trevat e Sipërme” të Shqipërisë, pushteti “legal” osman, po zëvendësohej me atë shqiptar, nga fundi i korrikut pushuan për një kohë veprimet luftarake ndërmjet fuqive kryengritëse shqiptare dhe forcave

<sup>25</sup> *Po aty*, Vj. 22-17-1763. Telegram i Halla-s drejtuar Markgraf-it, Manastir, 25 qershor 1912; *po aty*, Telegram nr. 70, i Halla-s drejtuar Markgraf-it, Manastir, 4 korrik 1912; *po aty*, telegram nr. 71. Shtojcë e informacionit nga Manastiri, 4 korrik 1912 (Lista e krerëve shqiptarë); *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914 (Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914)*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 571 (892); “Бегство из Дебра” (Bjegstvo iz Derba), gazeta *Политика (Politika)*, Бр. 3022, Београд, 18.06./1.07.1912.

<sup>26</sup> *Државен архив на Република Македонија (Državen Arhiv na Republika Makedonija)*, Скопје (Skopje) (më tej: *ДАРМ / DARM*), ф. Дипломатски архив-Белград (Diplomatski arhiv-Belgrad), М. 904, ПП Бр. 715, Битољ (Bitol), 11/24.07.1912, L. Mihajloviq, konsulli i Serbisë në Manastir, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Beograd, Bitol, 11-24 korrik 1912; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II (Rilindja Kombëtare, vitet '30 të shek. XIX-1912), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: Toena, 2002), 479-482.

<sup>27</sup> *Документи о спољној политици политици Краљевине Србије 1903-1914 (Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914)*, Књига 5, Свеска 1, dok. nr. 571 (892).

<sup>28</sup> “Дебар у пламену” (Debar u plamenu), gazeta *Политика (Politika)*, Бр. 3028, Београд, 24.06./7.07.1912.

<sup>29</sup> *Документи о спољној политици политици Краљевине Србије 1903-1914 (Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914)*, Књига 5, Свеска 1, dok. nr. 684 (1026).

osmane.<sup>30</sup> Qeveria e re osmane, më 23 korrik, kishte lëshuar një urdhër telegrafik mbi tërheqjen e ushtrisë nga Shqipëria, një telegram me përmbajtje të tillë kishte arritur edhe në Manastir. Pas urdhrit për tërheqjen e ushtrisë, qeveria osmane priste që kryengritësit shqiptarë të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre, dhe kështu të përfundonte kryengritja.<sup>31</sup> Kurse, më 12-25 korrik 1912, qeveria osmane urdhëroi ndërprerjen e të gjitha operacioneve ushtarake kundër shqiptarëve.<sup>32</sup>

---

<sup>30</sup> ДАРМ (DARM), Скопје (Skopje), ф. Дипломатски архив-Белград, М. 904, ПП Бр. 1292, Битољ, 11/24.07.1912, Л. Мihaljloviq, konsulli i Serbisë në Manastir, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Beograd, Bitol, 11-24 korrik 1912; *Документи о спољној политици политичи Краљевине Србије 1903-1914 (Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914)*, Књига 5, Свеска 1, dok. nr. 659 (997); *po aty*, dok. nr. 680 (1021); *po aty*, dok. nr. 682 (1024); *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, 484.

<sup>31</sup> ДАРМ, Скопје, ф. Дипломатски архив-Белград, М. 904, ПП Бр. 715, Битољ, 11/24.07.1912, Л. Мihaljloviq, konsulli i Serbisë në Manastir, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Beograd.

<sup>32</sup> “Преговори са Арнаутима” (Pregovori sa Arnautima), gazeta *Политика* (Politika), Бр. 3046, Београд, 12/25.07.1912.

